SIR NOEL MALCOLM

ALL SOULS COLLEGE OXFORD

Vepra







Përgatitur nga Mal Berisha

Qëllimi im ka qenë dhe mbetet të vë në pah atë që intelektualët britanikë kanë thënë dhe bërë për vendin dhe popullin tonë. Në dijeninë time, nuk ka asnjë popull në botë i cili të ketë nxjerrë aq shumë intelektualë të të gjitha fushave që të kenë treguar interes, respekt dhe ndjeshmëri ndaj fatit të kombit tonë sa brtianiket. Dua të shënoj se interesi dhe dashamirësia e intelektualëve britanikë, jo gjithmonë ka shkuar paralel me politikën britanike ndaj popullit tonë.

Qëllimi im ka qenë që duke sfiduar njeriun që ka marrë drejtimin e "mbrojtjes së vlerave të Parkut tonë Arkelologjik të Butrintit" të jap një shëmbull sesi nuk duhej në asnjë mënyrë të zgjidhej pikërisht ai që ka një koncept aq të gabuar ndaj trashëgimisë tonë mbi atë park. Në mesin e arkeologëve britanikë, ka aq shumë mjeshtra të arkeologjisë, sa edhe nëse supozojmë se Richard Hodges na qenka më i miri, gjë që nuk del të jetë e vërtetë, përsëri duhej të zgjidhej ai që do të kishte dashurinë që kanë 40 emrat që unë kam përmendur në këtë cikël të gjatë.

Dua ta mbyll ciklin, duke kërkuar ndjesë këtu pasi ka edhe të tjerë si këta të cilët e kanë nderuar Shqipërinë dhe shqipëtaret. Por ky cikël do të mbyllet me:

SIR NOEL ROBERT MALCOLM, i lindur më 26 dhjetor të vitit 1956. Ai është gazetar, historian, akademik, filozof dhe analist

politik anglez. Ka studiuar në Universitetin Kembrixh dhe ka doktoruar po aty në Kolegjin Trinity të Historisë. Sir Noel Malcolm ka punuar si gazetar politik si dhe i mardhënjeve me jashtë për gazetat “The Spectator” dhe “The Daily Telegraph”. Në atë detyrë ai e ngriti çështjen e Kosovës në shtypin më prestigjioz britanik si një zë i vëçantë në mbështetje të çështjes tonë kombëtare.

Autori i tre librave dhe qindra artikujve për ne shqiptarët, Sir Nol Malcolm është edhe ish President i Shoqatës Anglo-Shqiptare në Londër dhe prej disa vitesh President Nderi i Saj.

Ai u anëtarsua në Shoqatën Mbretërore të Letërsisë në 1997, dhe anëtar i Akademisë Britanike në vitin 2001. Që nga viti 2002, ai është studiues në kolegjin All Souls College, në Oxford. Në vitin 2014 ai u kurorëzua si Kalorës i Mbretëreshës Elizabeth II. Sir Noel Malcolm është Anëtar i Akademisë së Shkencave dhe Arteve të Kosovës. Po ashtu ai ka marrë Medaljen e Akademisë Britanike për librin e tij studmor mbi Thomas Hobbes.

Më poshtë sinopsi i tre librave për ne shqipëtarët:

KOSOVA NJË HISTORI E SHKURTËR

Përmbajtja: Vendet, emrat dhe popujt. Origjina: Serbët, shqiptarët dhe vllehët. Kosova mesjetare para Princit Lazar: 850-1380. Beteja dhe Miti. Vitet e fundit të Kosovës Mesjetare Serbe: 1389-1455. Kosova e hershme osmane: 1450-1580.

Lufta, Rebelimi dhe Jeta Fetare: 1580-1680. Pushtimi austriak dhe "Migrimi i madh" i serbëve: 1689-1690. Rimëkëmbja dhe rënia: 1690-1817. Reforma dhe Rezistenca: 1817-1878. Minoritetet e tjera të Kosovës: vllehët, ciganët, turqit, hebrenjtë dhe çerkezët. Nga Lidhja e Prizrenit tek Revolucioni Xhonturk: 1878-1908. Rebelimet e Mëdha, Pushtimi Serb dhe Lufta e Parë Botërore, 1908-1918. Kaçakët dhe kolonizatorët: 1918-1941. Kosova e okupuar në Luftën e Dytë Botërore: 1941-1945. Kosova nën Titon: 1945-1980. Kosova pas vdekjes së Titos: 1981-1997.

“AGJENTËT E PERANDORISË”

Në promovimin e këtij libri në Londër, morën pjesë miq të Sir Noel Malcolm të një elite të lartë angleze, editorë të gazetave të njohura vendase si: Telegraph, Charles Moore, Drejtori i Institutit Mbretëror të Antropologjisë Z.David Shankland, editori i Revistës Standpoint Z.Daniel Johnson, arkitekti i famshëm Mark Willingalle, gazetari i njohur Harry Eyres, stërnipi i Ambasadorit të parë Britanik në Tiranë në vitin 1922 Sir Augustos Harry Eyres, krye editorët e Shtëpisë Botuese Penguin dhe Random House, historiani më I njohur anglez Paul Johnson, etj. Deviza e këtij libri është:

“Nëse dikush dëshironte të bënte tregti me Perandorinë Osmane, ishte shumë e rëndësishme të njihte një shqiptar”.

Revista prestigjoze “The Economist” shkruan për këtë libër:

“Libri i Noel Malcolm tregon në mënyrë gjeniale ekuilibrin ndryshues të forcave midis Perandorive Veneciane dhe asaj Osmane, ku fuqitë detare ishin në konkurrencë se kush do të zotëronte Mesdheun Lindor dhe se si disa të krishterë jetonin mirë duke i shërbyer Perandorisë Osmane ndërsa disa myslimanë depërtonin brenda Perandorisë Veneciane”.

REBELËT, BESIMTARËT, TË MBIJETUARIT

Në këtë libër, hidhet një “Vështrim i gjërë mbi Shqipërinë e shekullit XV” të: “Kelmendi: Shënime mbi historinë e hershme të një fisi katolik shqiptar”, “Një tregim i panjohur për Shqipërinë Otomane”, “Traktati i Antonio Brunit mbi Beylerbeylik-un e Rumelisë (1596)”, “Shtojcë: Huazimet e Soranzo-s nga Traktati i Brunit”, “Kriptokrishterimi dhe amfibianizmi fetar në Ballkanin Ottoman”, “Shqiptarët e periudhës së hershme moderne në duart e Inkuizicionit”, “Cuneus Prophetarum e Pjetër Bogdanit (1685)”, “Emigrimi në masë i serbëve nga Kosova (1690)”, “Ali Pasha dhe Britania e Madhe gjatë Luftërave Napoleonike”, “Diplomacia britanike dhe Lidhja e Prizrenit, 1878-1880”, “Autobiografia e parë shqiptare Ernesto Cozzi (1870-1926): Figurë e shpërfillur në studimet shqiptare dhe në historinë e Shqipërisë” dhe “Mitet e identitetit kombëtar shqiptar”.

Për historianin britanik Noel Malcolm, historia e tokave shqiptare është pak e njohur dhe pak e studiuar, “një fakt

zhgënjyes, por jo edhe befasues". Pasojë e një shpërfilljeje dhe ndjesie izolimi gjatë kohës së komunizmit, megjithatë tokat shqiptare, sipas historianit të njohur, kanë një histori të gjatë të ndërveprimit me të tjerët.

Sir Noel Malcolm është një prej britanikëve më dashamirës të historisë, kulturës dhe vetë popullit shqiptar kudo ku jemi, në trojet tona apo të vendosur në vende të tjera perëndimore.

Ai eshte laurat i cmimit "GJERGJ KASTRIOTI SKËNDERBEU" akorduar nga Presidenti i Republikës së Shqipërisë, z. Bujar Nishani; Laurat i MEDALJES SË ARTË TË LIDHJES SË PRIZRENIT akorduar nga Presidenti i Kosovës Hashim Thaci.